

TRAJNIM ME PROFESORËT DHE STUDENTËT E STUDIMEVE MASTER NË FAKULTETIN “INXINIERIA E ENERGJISË”

Në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me kompaninë **Schneider Electric**, **Fakulteti i Inxhinierisë së Energjisë** më datat **06.12.2025 dhe 07.12.2025**, në objektet e **UBT-së**, organizoi një trajnim për profesorët dhe studentët e studimeve **Master** të këtij fakulteti.

Kompania **Schneider Electric** i dhuroi këtij fakulteti licencat për përdorimin e dy softuerëve profesionalë: **“EcoStruxure Power Design”** dhe **“EcoStruxure Power Build”**, për të cilët u organizua edhe një trajnim dyditor lidhur me përdorimin e tyre.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që studentët e studimeve Master, përmes këtyre dy softuerëve, të aftësohen për projektimin dhe përgatitjen e projekteve për linjat e **tensionit të ulët dhe tensionit të mesëm**, duke inkorporuar komponentë të ndryshëm elektroenergjetikë, si: **transformatorë, gjeneratorë, motorë, linja, zbarrat, stabilimente shpërndarëse, ndërprerës, siguresa**, si dhe ngarkesa të ndryshme elektrike.

Po ashtu, edhe profesorët do të jenë në gjendje që në të ardhmen ushtrimet praktike në lëndët e tyre t’i realizojnë përmes këtyre softuerëve modernë.

Në fund të trajnimit, studentëve pjesëmarrës iu ndanë detyra projektuese, të cilat do t’i zhvillojnë brenda një afati të caktuar dhe do të kenë mundësi t’i prezantojnë në kuadër të lëndës së studimeve Master **“Analiza e Avancuar e Energjisë”**, ku gjithashtu do të pajisen edhe me **certifikata të pjesëmarrjes** nga kompania **Schneider Electric**.







